



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and
Industry

03/1025

6015

2

12 07 19

Në pajtim me dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 03/ L -149, Rregullore Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovë, si dhe Rregullore Nr. 21/2012 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civil , Ministria e Tregtisë dhe Industrisë shpallë:

REKRUTIM I BRENDSHËM

Institucioni:

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

Departamenti i Turizmit

Titulli i vendit të punës: Udhëheqës i Divizionit për hartimin e politikave të turizmit
Koeficienti / 9

Nr. i Referencës: MTL/ 11

Numri i zyrtarëve që do të pranohen: 1

Vendi: Prishtinë

Datë: 12.07.2019

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Menaxhon punën e përgjithshme të divizionit dhe ndihmon Drejtorin në caktimin e objektivave dhe zhvillimin e planit të punës për përmbushjen e këtyre objektivave
- Menaxhon stafin e divizionit, dhe në bashkëpunim me Drejtorin, organizon punën përmes ndarjes së detyrave tek të varurit, ofron udhëzime dhe monitoron punën e stafit për të ofruar produkte dhe shërbime cilësore;
- Ndihmon Drejtorin në vlerësimin e proceseve dhe procedurave të brendshme dhe rekomandon ndryshime / përmirësime me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe cilësisë së punës;
- Zhvillon dhe propozon politika në lidhje me zhvillimin e turizmit dhe mbikëqyrë zbatimin e tyre;
- Përcjellë dhe analizon zgjidhjet dhe praktikat ligjore të BE në fushën e turizmit, si dhe propozon dhe harton akte ligjore të ndërlidhura me zhvillimin e turizmit dhe efikasitetin e tij;
- Koordinon punën dhe bashkëpunon me menaxherët tjerë në instiucion;
- Bën vlerësimin e rregullt të stafit nën mbikëqyrje të tij/saj dhe përkrahë zhvillimin e tyre përmes trajnimit për kryerje të detyrave të tyre në përputhje me standardet e kërkuara.

- Monitoron dhe matë efikasitetin e masave të politikës mbi konkurrueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e turizmit të Kosovës, si dhe përcjellë treguesit e konkurrueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së turizmit të Kosovës.

Kualifikimet për këtë vend të punës:

- Diplomë universitare : Fakulteti i Turizmit, Ekonomik apo Shkencat Shoqërore;
- Minimum 5 vite përvojë pune profesionale;
- Njohuri dhe përvojë substanciale në fushën e turizmit;
- Aftësi komunikuese, negociuese dhe bindëse në menaxhim;
- Shkathtësi në caktim të objektivave , planifikim të punës dhe analizë ;
- Shkathtësi në udhëheqje dhe organizim të ekipit, aftësi për të menaxhuar një ekip ose grup punues;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve MS Office dhe internetit;
- Njohja e mirë e gjuhës angleze është e preferuar;

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë zyrtarët e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë shkollimin e lartë dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave.

Kohëzgjatja e emërimit:

Nëpunësi i karrierës (përhershëm) Periudha provuese .Dymbëdhjetë (12) muaj.

Data e mbylljes së konkursit:

19.07.2019.

Paraqitja e kërkesave

Formularët për aplikim mund të merren në recepcion të MTI-së, ose të tërhiqen nga *web* faqja e MTI-së, ku është bërë edhe shpallja e konkursit , në adresën www.mti-ks.org dhe dorëzohen në Divizionin e Burimeve Njerëzore, çdo ditë pune nga ora 8:00 -16:00 deri më:19.07.2019. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr. tel. 038-200 36-578.

“Shërbimi Civil i Republikës së Kosovës, ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë”.

“Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcionalë organet e shërbimit civil të administratës publike,qendrore dhe lokale,siç specifikohet në Nenin 11, paragrafi 3të Ligjit Nr..03/L-149 mbi shërbimin Civil të Republikës së Kosovës”

Kërkesat e pakompletuara si dhe kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar,vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.